Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

### Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

## FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  10. Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |

**Shtojca2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventividhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomikee detajuar**

| <b>Nr</b>            | <b>Nr. Analizë</b> | <b>Përshkrimii Punëve</b> | <b>Njësi</b> | <b>Sasia</b> | <b>Çmimi/<br/>Njësi</b> | <b>Cmimi total</b> |
|----------------------|--------------------|---------------------------|--------------|--------------|-------------------------|--------------------|
| 1.                   |                    |                           |              |              |                         |                    |
| 2.                   |                    |                           |              |              |                         |                    |
| 3.                   |                    |                           |              |              |                         |                    |
|                      |                    |                           |              |              |                         |                    |
| <b>Shuma</b>         |                    |                           |              |              |                         |                    |
| <b>Fondi Rezervë</b> |                    |                           |              |              |                         |                    |
| <b>Shuma</b>         |                    |                           |              |              |                         |                    |
| <b>TVSH</b>          |                    |                           |              |              |                         |                    |
| <b>SHUMA TOTAL</b>   |                    |                           |              |              |                         |                    |

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
 [Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetitkontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [llojiiprocedurës]

Përshkrimishkurtërikontratës: [objekti]

Publikimi (nësezbatohet):BuletiniNjoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-  
se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emriiofertuesit të siguruar] kaderdhurnjëdepozitëpranë[emridheadresa e bankës] / është garantuarpranë[emridheadresa e kompanisë së sigurimit] me njëvlerë prej [monedhadhe vlera, e shprehur në fjalëdheshifra] sikusht për sigurimin e ofertës, dorëzuarnga operatori ilartpërmendur ekonomik.

Marrimpërsipër të transferojmë në llogarinë e [emrii autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëveengakërkesa juaj e thjeshtëdhe e parë me shkrim, pa kërkuarshpjegime, me kushtqëjokërkesë të përmendëmospërmbushjen e njëritngakushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e katërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatitpërfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatitpërfundimtar, nëse është përcaktuarqështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoritetikontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 4.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |



|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  |  |  |
|  |  |  |  |

## VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

### Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor ]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

### Bashkëlidhur DST-së

Specifikimi i Materialeve:

### Bashkëlidhur DST-së

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### Bashkëlidhur DST-së

**Shtojca 6**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve:** Bashkëlidhur DST-së

| <i>1</i> | <i>2</i>            | <i>3. Afati i realizimit</i> |                |                |                |                |
|----------|---------------------|------------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Nr       | Përshkrimi i Punëve | Java 1/Muaji 1               | Java 2/Muaji 2 | Java 3/Muaji 3 | Java 4/Muaji 4 | Java 5/Muaji 5 |
| 1.       |                     |                              |                |                |                |                |
| 2.       |                     |                              |                |                |                |                |

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

**Shtojca 7** [Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]**FORMULAR I I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT****1. KRITERET E PERGJITHSHME TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurese, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është denuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-se;
- ç) personi (personat) që vepron si anetar i organit administrativ, drejtori ose mbikeqyresi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i denuar ose nuk ka qenë i denuar nga një vendim i gjykatës i formës së prapë për çdo veprë penale, të percaktuar në nenin 76/1 të LPP-se;
- d) nuk është denuar me vendim gjyqësor të formës së prapë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-se;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anetarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikeqyres i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimarrëse ose kontrolluese brenda

tij persona te cilet jane/kane qene ne kete cilesi ne nje operator ekonomik te perjashtuar nga e drejta per te perfituar fonde publike, me vendim te Agjencise se Prokurimit Publik, gjate kohes qe ky vendim eshte ne fuqi.

Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip.

Keto kritere duhet te permbushen me paraqitjen e Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te operatorit ekonomik ne ditën e hapjes se Ofertes, sipas **Shtojces 8**.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, secili anetar i grupit duhet te paraqese Vetedeklarimin e lartpermendur.

Ne rast se, operatori ekonomik ofertues do te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera, Vetedeklarimi i lartpermendur duhet te paraqitet edhe nga subjekti mbeshtetes.

Kriteret e Pergjithshme te Pranimit nuk duhet te ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Ne çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme per vertetesine e informacionit te deklaruar nga Operatori Ekonomik, per sa me siper.

Nese oferta paraqitet nga nje Bashkim Operatoresh Ekonomike, do te paraqitet :

- Marreveshje bashkepunimi ndermjet Operatoreve Ekonomike, ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesemarrjes ne bashkm, dhe elementet qe merr persiper te realizoje secili prej anetareve te bashkimit.
- Nese, nje operator ekonomik deshiron te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera, ai i verteton autoritetit kontraktor se do te kete ne dispozicion burimet e nevojshme, duke dorezuar nje angazhim me shkrim te ketyre subjekteve per kete qellim.

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **Argumentimi:**

**Argumentimi:** Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7.1.

### Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore 3 (tri) viteve të fundit financiare lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin e **maturuar** për adresën ku ai ushtron aktivitetin sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit).*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

### 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**ose**

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa fondi limit i kontratës që prokurohet.

**Plotesimi i njërit prej kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

**Vleresimi i pervojes se suksesshme te Operatorit/ve Ekonomik do te kryhet bazuar ne dokumentat e meposhtme:**

- i) Per kontrata te realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet te paraqes/in dokumentacionin e meposhtem, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, per te vertetuar permbushjen e suksesshme te puneve:
1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqeruar me:
  2. Kontraten/at e Siper marrjes;
  3. Situacionin perfundimtar te objektit;
  4. Aktin e kolaudimit;
  5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim;
  6. Faturat tatimore te prera per objektin;

Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktesisht cilesine e kryerjes se puneve, faktin nese kontrata eshte realizuar me sukses, perqindjen e punimeve ne rast bashkimi te shoqerive, etj.

- ii) Per kontrata te realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet te paraqes/in dokumentacionin e meposhtem:
1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqeruar me:
  2. Kontraten/at e Siper marrjes;
  3. Situacionin perfundimtar te objektit;
  4. Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
  5. Fatura tatimore perfundimtare.
- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
  - Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
    - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
    - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet shtetërore kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a) Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Për inxhinieret Drejtues Teknik te mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune noteriale e vlefshme,
- Diplome

Të figurojnë në listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 të paktën minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 2(dy) manovrator per mjetet e renda ,dhe 1 (një saldator) për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Deshmi e Aftesise Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Për punonjesit manovrator, ofertuesi duhet të paraqesë:

Kontratën individuale të punës te vlefshme;

Leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.)

*Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. 1 (nje) punonjës që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier" shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ certifikate si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 12 persona**, të cilët duhet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar
- b) Listëpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

**2.3.7.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Nr. | Emri I mjetit             | Njësi | Sasi | Statusi                |
|-----|---------------------------|-------|------|------------------------|
| 1   | Autobetoniere kantieri    | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |
| 2   | Fadromë                   | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |
| 3   | Eskavator me zinxhir      | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |
| 4   | Kamion mbi 7.5 ton        | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |
| 5   | Vibrator betoni           | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |
| 6   | Kamion me vinç mbi 10 ton | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |
| 7   | Saldratrice               | Copë  | 1    | Në pronësi ose me qira |

| Nr. | Mjete mbrojtëse          | Njësi | Sasi | Statusi                |
|-----|--------------------------|-------|------|------------------------|
| 1   | Kokore/helmeta mbrojtëse | Copë  | 12   | Në pronësi ose me qira |
| 2   | Jelekë                   | Copë  | 12   | Në pronësi ose me qira |
| 3   | Fikse Zjarri             | Copë  | 5    | Në pronësi ose me qira |
| 4   | Tabela Sigurimi Teknik   | Copë  | 10   | Në pronësi ose me qira |
| 5   | Kuti Ndhme e Shpejtë     | Copë  | 5    | Në pronësi ose me qira |
| 6   | Prozhektot për ndriçim   | Copë  | 2    | Në pronësi ose me qira |

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat dhe licencat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së parashikuar për zbatimin e kontratës.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën që në rast se afatet e vlefshmërisë së certifikatave përfundojnë pas përfundimit të procedurës, të verifikojë rinovimin dhe pajisjen e operatorit ekonomik tëshpallurfitues/kontraktorit meçertifikatat e mësipërme.

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinierë, bashkëngjitur DST ne SPE.*

**Te gjitha dokumentet duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.**

**Shtojca 8.**

### **FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

|                     |                  |
|---------------------|------------------|
| <b>Identifikimi</b> | <b>Përgjigja</b> |
|---------------------|------------------|



|  |       |
|--|-------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ----- |
| Numri NIPT/et:   | ----- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar  | ----- |
| Përfaqësuesi (emri):   | ----- |
| Telefoni:  | ----- |
| E-mail:  | ----- |

## B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT – i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|----------|-----------------------------|---|
|                                     |          |                             |   |
|                                     |          |                             |   |
|                                     |          |                             |   |

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|--|--------------------------------------|
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |

|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

|  |
|--|
| <b>Deklarata</b>   |
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>  |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>   |
| <p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>   |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>   |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>   |
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>   |

|   |
|---|
| <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>   |
| <p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>  |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

|  |
|--|
| <p>Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;</li> <li>2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;</li> <li>3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;</li> <li>4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;</li> <li>5. Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo sibashkim operatorësh ekonomik, që: <ol style="list-style-type: none"> <li>a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërënga Autoriteti Kontraktor;</li> <li>b) është një ofertuesimundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.</li> </ol> </li> <li>6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; <input type="checkbox"/> </li> <li>b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë</li> </ol> </li> </ol> |
|--|

konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendurmëlart, nuk kapasurkonsultime, komunikime, kontratëapomarrëveshje me ndonjëkonkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëlliminapovendimin për të paraqitur apo jo njëofertë; ose,
- d) paraqitjen e njëoferteqë nuk iplotësonspecifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveçkësaj, nuk kapasurkonsultime, komunikime, marrëveshjeapokontrata me ndonjëkonkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimetapodërgesa të veçanta të produkteveaposhërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kurjanëdeklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janëbërë të njohuradhe as nuk do t'ubëhen të njohura me qëllimngaOfertuesikonkurrentëve të tjerë, në çdomënyrëqoftë, para datësdhekohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljesfituesdhelidhjes së kontratës, vetëmnësekërkohet me ligj ose nësedeklarohen në mënyrëspecifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në

rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

| Deklarata  |
|--|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</li> </ul> |
| <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____   |

#### Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

##### A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

| Deklarata  | Përgjigje     |
|--|---------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç | Po [ ] Jo [ ] |

|   |  |
|---|--|
| <p>udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimittë përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</p> |  |
|---|--|

**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

| Deklarata  | Përgjigje   |
|--|---|
